

PROF. DR. SHEFIK OSMANI – MENDIMTARI I SHQUAR I PEDAGOGJISË SHQIPTARE

Në këtë artikull janë objekt dy veprimtari të profesorit të nderuar:

1. *Botimi “Përjetë me Shefikun”, monografi me autore Urti Osmani, “Mësuese e Popullit”,*
2. *Rreth shtatë botimeve të Prof. dr. Shefik Osmani.*

Veprimtaria e parë

Ka pak kohë që me rastin e 1-vjetorit të ndarjes nga jeta të Prof. dr. Shefik Osmanit, zonja e tij shkruan librin objekt, që përpiqet të paraqes jetën familjare të profesorit tonë të nderuar.

Me prof. Shefikun jam njohur që në bankat e shkollës pedagogjike, kur ai ishte drejtor dhe zhvillonte lëndën e Pedagogjisë. Më kujtohet edhe tani që na dëshmonte me pasion pedagogët e njohur botërorë, si: *Pestalozin, Ushinskin* etj. E kam ndjekur vazhdimisht në punën e tij shkencore dhe botuese. Në vitet '90 të shekullit të kaluar bashkëpunova për disa vjet me të për hartimin e monografisë “*Abetaret shqipe...*”, botuar në vitin 2000 nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Gjatë kontakteve me të (teksa profesori i ka regjistruar të gjitha takimet tona), njoha për së afërmi ish-mësuesit tanë të pedagogjisë të viteve '60 të shekullit XX. Ai ishte siç e kisha njohur, intelektual me cilësi të qenësishme të një qytetari atdhetar, idealist, shkencëtar me përvojë, didakt me kulturë të gjërë e praktikë të gjatë, njohës i disa gjuhëve të huaja. Në punë e sipër njoha aftësitë për analiza, gjykime dhe sinteza për jetën e tij pedagogjike – shkencore.

Është shumë e vështirë të rrokësh idetë që janë trajtuar në këtë libër të vëllimshëm prej 286 faqesh, ku është pasqyruar jeta e veprimtaria shkencore dhe vetjake e profesor Shefikut, që në përfundim të leximit të librit dëshmohet bindshëm së është **Përjetë me Shefikun**. Duke lexuar librin të shkon padyshim mendja, pas

kujtimeve, dhe pyet veten: “Si ka mundësi të ketë njerëz të përsosur pa asnjë të metë? Si ka mundësi që marrëdhëniet bashkëshortore të jenë kaq të përkryera?”. Unë, si shumë të tjerë që kemi patur rastin ta njohim nga afër do t’i përgjigjesha: “Urtia e ka përshkruar Shefikun tamam ashtu siç ka qënë, ndërsa marrëdhëniet e tyre bashkëshortore ne i kemi marrë shembull...”⁽¹⁾

Kur analizojmë veprimtarinë që ka kryer Profesor Shefikun, **jemi të bindur se kush jeton pas vdekjes, i përket historisë.** Gjatë leximit të librit, njihemi me veprimtarinë e profesorit, nepërmjet këtyre krerëve: 1. Njohja dhe mbresa nga jeta bashkëshortore; 2. Ngjarje të shënuara; 3. Veprimari shkencore e atedhetare; 4. Shënime dhe mbresa nga udhëtimet; 5. Vlerësime, dekorime dhe dedikime; 6. Vetmia, nuk kapërdihet; 7. Ligjërata, përmes fotografive.

Gjithë veprimtaria shkencore e Profesorit tonë të nderuar, e cila përfshin 40 libra, të llojeve të ndryshme social - pedagogjike dhe kulturore - shkencore, për historinë e arsimit. Vepra enciklopedike “**Fjalor i Pedagogjisë**” që u vlerësua me “Laureat i Çmimit të Republikës”, “**J. H. Pestaloci- reformator i madh i arsimit**”, “**Reflekse etopedagogjike- I**”, “**Shpalime enopedagogjike**”, **V. II**, “**Probleme të mësimdhënies**”, për ciklin e ulët të shkollës tetëvjeçare, “**Trashëgimi social-pedagogjike-Motrat Qiriazit**”, “**Një misonar në shërbim të kombit**”, “**J. H. Pestaloci dhe arsimit fillor**”, “**Naim Frashëri-7**”, “**Pateoni Iranian dhe iranologët shqiptarë**”, “**Pjetër Bogdani**”, “**Historia e shkollës shqipe të mësimi plotësues në Zvicër**” (me bashkautor Mahir Mustafa), “**Abetaret shqipe...**”(me bashkautor Nj. Kazazin). Dëshmojnë edhe vepra të tjera me bashkautor, si: “**Didaktika**” dhe “**Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar - I**” etj. Gjithashtu, profesori i nderuar ka shkruar edhe qindra artikuj në shtypin shkencor (brenda dhe jashtë vendit), për të cilat kemi dëshmuar në “*Buletin shkencor*”, Seria e shkencave të edukimit, USH “Luigi Gurakuqi”, në nr. 54-55.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore (1942-1943) Prof. dr. Shefik Osmani nisi studimet universitare në Universitetin e Barit. Aty u etiketua “*persona non grata*” ndaj dhe e larguan duke i lejuar të studionte vetëm në Italinë e Veriut, në Firence⁽²⁾. Kështu, ëndrra

⁽¹⁾ Urti Osmani, *Përjetë me Shefikun*. Botim i parë, FILARA, 2013, fq. 263.

⁽²⁾ Njazi Kazazi, *Në gjurmët e një didakti* (Nga veprimtaria dhe trashëgimia e

për t'u bërë mjek "u shua". Trokiti në Institutin Pedagogjik dhe Universitetin e Tiranës.

Duhej të vinin fillimet e viteve '90 për të rifilluar ai veprimtarinë. Për këtë dëshmon znj. Urti: në Itali (3 herë), Rumani, Maqedoni (13 herë), Turqi (2 herë), Zvicër (5 herë), Gjermani (2 herë), Holandë, Iran, Kosovë (7 herë), Emiratet e Bashkuara Arabe (3 herë), Belgjikë, Arabia Saudite (2 herë), Egjipt, Suedi, duke marrë pjesë veç të tjerave edhe për SHSHMP, për rishikimin e programeve dhe kurrikulave të tyre.

Libri është punuar më shumë dashuri nga Zonja e nderuar dhe paraqet çastet më themelore që nga shfaqja e ndjesisë së parë deri në fundin e jetës së tij, për të arritur tek titulli I librit "**Përjetë me Shefikun**", si mike e ngushtë, bashkëpunëtoresh e afërt në të gjitha sfidat e jetës.

Libri është shoqëruar me shumë fotografi, faksimile letrash origjinale të shkruara nga profesori. Është kënaqësi të lexosh librin, botimin e të cilit u realizua në shtyshkronjën "Mileniumi i ri".

Në revistën "Univers", përveç shkrimeve redaksionale, autori ka kontribuar edhe me artikullin: "**Alhamiada shqiptare**" (me bashkautor Njazi Kazazin)⁽³⁾.

Në vijim për këtë botim po bëjmë objekt një pjesë nga libri i Prof. Dr. Vehbi Hotit në shkrimet e tij kushtuar çiftit Osmani:

"Urtia u bë shoqe e jetës, e punës dhe e krijimit të Shefikut. Një çift bashkëshortësh për t'u pasur zili, kudo e kurdoherë bashkë, 'si vëllezëit siamezë', kur përmendet njëri, vetvetiu të shkon mendja tek tjetri. Nuk di sesi çifti Shefik-Urti më krijojë pa dashur të vë shënjen e barazimit, një farë shëmbëlltyre të çiftit të famshëm Marie e Pjer Kyri, për nga bashkëkohësia e vlerave bashkëshortore dhe intersave intelektuale, studimore e shkencore, nga përkushtimi e solidariteti reciprok vetmohues".⁽⁴⁾

didaktit Shefik Osmani), Instituti Tiranë, 2005, fq. 27.

⁽³⁾ "Univers", Tiranë, 2004, nr. 5, fq. 195-204.

⁽⁴⁾ Vehbi Hoti, *Ethem Osmani, "Mësues i Popullit"*, Shkodër, 2012, fq. 19.

Veprimtaria e dytë

Libri i parë, **“Vlerësime për prof. dr. Shefik Osmanin”**, Tiranë, 2014, 384 faqe, përfshin shkrime për veprimtarinë dhe krijimtarinë e Profesor Osmanit nga miq, kolegë, dashamirës, ish-nxënës dhe bashkëpunëtorë nga shumë krahina të vendit si dhe nga jashtë, duke filluar nga viti 1944 deri në 2013. Ata kanë vënë në dukje punën e tij plot dashuri, përkushtim e vetmohim në dobi të atdheut, të arsimit dhe të kulturës kombëtare.

Libri i dytë, **“Figura të shquara të arsimit dhe të pedagogjisë”**, Tiranë, 2014, 400 faqe. Në të trajtohen kontributet e rreth 50 personaliteteve, që përfshihen në disa shekuj, duke filluar nga koha e Skenderbeut e gjer në fillimet e shekullit XXI. Dëshmohet për *Pjetër Bogdanin, Muhamet Çamin, Hasan Tahsinin, vëllezërit Frashëri, Kristoforidhin, Luigj Gurakuqin, Vehbi Dibrën* etj. Bëhen objekt edhe autorë të Lindjes dhe të Perëndimit, si: *El Gazaliu, Konarski* etj. Në këtë botim dëshmohet qartë erudicioni i autorit.

Libri i tretë, **“Ligjërata dhe shkrime të zgjedhura”**, Tiranë, 2014, 397 faqe. Në të trajtohet tematika e trashëgimisë së shkollës, didaktikës, gjuhës dhe problemeve social pedagogjike, të botuara në shtypin shqiptar si edhe të vendeve fqinje. Këtu zënë vend edhe ngjarje arsimore me rëndësi kombëtare të hershme dhe më të vona, artikujt studimorë mbi abetaret shqipe etj.

Libri i katërt, **“Probleme të ciklit të ulët në rrjedhën e viteve”**, Tiranë, 2015, 422 faqe. Përfshihen 50 artikuj, kumtesa, referime të shtrira në një kohë më shumë se gjysmëshekulli, nga viti 1953 gjer më 2009. Botimi është dëshmi e qartë se autori përfaqëson njërin nga njohësit më të mirë e kompetentë për probleme të ciklit të ulët. Punimet që përmban ky botim mbështeten në përvojën e gjatë të autorit si mësues dhe drejtues arsimit.

Libri i pestë, **“Kontribut për historinë e filatelistëve shqiptarë”**, Tiranë, 2015, 238 faqe. Ky botim, do të ndihmojë filatelistët sa herë që atyre do t’u nevojitet të dinë diçka për filatelinë.

Libri i gjashtë, **“Probleme të ciklit të ulët të arsimit dhe të kulturës”**, Tiranë, 2016, 418 faqe. Autori trajton dy tema kryesore: “Problemet e ciklit të ulët” dhe “Disa probleme të përgjithshme të arsimit kombëtar dhe të kulturës shqiptare.” Në shkrimet e botimit objekt, si edhe në të mëparshmit, dëshmohet horizonti kulturor dhe dijet e gjëra të profesor Shefikut si në fushën e

arsimit, ashtu dhe në atë të kulturës së përgjithshme e të historisë së popullit tonë. Ka shkrime që janë hartuar me bashkëautorësi. Kjo tregon se ai ka qenë human, duke i ndihmuar më të rinjtë me dijet dhe përvojën e vet. Vepra e profesor Shefikut përmban përvojë të çmuar që meriton të njihet.

Libri i shtatë, **“Vështrime mbi studime e botime për shkollën, shkencën dhe kulturën”**, Tiranë, 2016, 339 faqe. Vepra përmban ese, homazhe, hyrje studimore, parathënie e recensione për libra të kolegëve etj. Në shkrimet e këtij libri, shfaqet personaliteti dhe kultura e gjerë profesionale, interesimi për veprimtarinë shkencore të kolegëve, natyra miqësore dhe dashamirëse e profesor Shefikut ndaj studiuesve.

Pjesë përbërëse e veprimtarisë kushtuar Profesorit të nderuar është edhe botimi **“Bibliografi e veprave, artikujve dhe ligjëratave të prof. dr. Shefik Osmanit dhe e shkrimeve për të”**, Tiranë, 2015, 148 faqe, me autorë Urti Osmanin dhe Njazi Kazazin.

Për një vlerësim më të drejtpërdrejtë, po zbardhim një vlerësim nga Prof. dr. Emil Lafe recenzenti i librit: *“Bibliografia e Prof. dr. Shefik Osmanit është një ndihmë e madhe për studiuesit e historisë së shkollës shqipe, të mendimit pedagogjik, të problemeve që ka pasur arsimit ynë nga gjysma e dytë e shekullit XX e deri në dhjetëvjetshin e parë të shekullit tonë, pasi autori ka qenë përherë i pranishëm dhe protagonist në këto fusha.”*

Urti Osmani, *Përjetë me Shefikun*. Botim i parë, FILARA, 2013, fq. 263.

Njazi Kazazi, *Në gjurmët e një didakti* (Nga veprimtaria dhe trashëgimia e didaktit Shefik Osmani), Instituti Tiranë, 2005, fq. 27.

“Univers”, Tiranë, 2004, nr. 5, fq. 195-204.

Vehbi Hoti, *Ethem Osmani, “Mësues i Popullit”*, Shkodër, 2012, fq. 19.